

**VENDIM**  
**Nr. 32, datë 23.9.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR  
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.2.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 23.9.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës’”,

**VËREN SE:**

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës me shkresën nr. 4410 prot. datë 29.8.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit teknik”; plotësimet me *e-mail*, datë 6.9.2024, me lëndë: “Kthim përgjigje për ndryshimin e të dhënave në licencën e ‘SHRUKD’ sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958, dhe Rregullores së licencimit, të ndryshuar;

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pranoi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës për rinovim licence për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me vendimin nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi i ri teknik i shoqërisë z. Olsen Kavalli, i cili zëvendëson ish drejtuesin teknik z. Gerald Dautaj, ka diplomë *Bachelor* në inxhinieri elektrike, me profil “Profesional – Energjetikë” në vitin 2011, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjithashtu, disponon diplomë Master shkencor në “Politika dhe administrim”, viti 2019, Profili Administrim Publik, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe Master i shkencave në Teknologji Informacioni, vitin 2013, në universitetin jopublik Kristal.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë ka marrë në konsideratë kërkesat e ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së licencimit, të ndryshuar, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit referuar eksperiencës mbi 10-vjeçare pranë kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2(b) e vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës”, ndryshon si më poshtë:

b) Drejtues teknik: z. Olsen Kavalli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE  
**Ediola Braha**